

316.42-055

Gëzim Xhambazi¹

Bukurije Rahmani²

Jehona Jonuzi³

Arbërina Xhambazi⁴

**(PA)BARAZIA GJINORE NË RRJEDHËN E NDRYSHIMEVE
SHOQËRORE**

**РОДОВАТА (НЕ)РАМНОПРАВНОСТ ВО ТЕКОТ НА
ОПШТЕСТВЕНИ ПРОМЕНИ**

**GENDER (IN)EQUALITY IN THE COURSE OF SOCIAL
CHANGES**

Abstract

In the social aspect, the world was faced with numerous transformations in different time periods. Human nature always insists on overcoming social disagreements, in the advancement and the humanization of interhuman relations. The history shows us that mankind slipped through many social systems, which duration depended by many factors, but mostly by spiritual and cultural preparation of the people in general. And when the level of human development became aware about deficiencies in the current social systems, in different ways increased the pressure for changes. These changes have not always been accompanied with planned results, because in many cases they resulted with unintended consequences. New social situations, on the one hand improved the old and unaccepted behaviors, and on the other hand replaced disagreements between different social groups with new and unknown issues. It seems that this is one of the strongest reasons for the continuity of

¹ Doktor në studime gjinore-shkenca sociologjike, Universiteti Shtetëror i Tetovës, gezimxh@yahoo.com

² Profesoreshë e grupit klasor, SHF "Milto Gurra", Cërvicë-Kërçovë.

³ Profesoreshë e grupit klasor, SHF "Milto Gurra", Cërvicë-Kërçovë.

⁴ Studente në vitin e dytë, Programi studimor: Psikologji, Universiteti Shtetëror i Tetovës.

the gender inequality phenomenon, which continues to remain one of the most current social issues in all countries worldwide.

Keywords: gender equality, social changes, discrimination

Abstrakt

Në aspektin social, bota u ballafaqua me transformime të shumta në periudha të ndryshme kohore. Natyra njerëzore çdoherë insiston në tejkalimin e mosmarrëveshjeve sociale, në përparimin dhe në humanizimin e raporteve ndërnjerëzore. Historia na dëshmon se njerëzimi kaloi nëpër shumë sisteme shoqërore, kohëzgjatja e të cilëve varej nga shumë faktorë, por më së shumti nga përgatitja shpirtërore dhe kulturore e njerëzve në përgjithësi. Dhe kur niveli i zhvillimit njerëzor vetëdijesohej për mangësitë në sistemet shoqërore aktuale, në mënyra të ndryshme rriste presionin për ndryshime. Këto ndryshime nuk pasoheshin çdoherë me rezultate të planifikuara, për arsye se në shumë raste ato rezultonin me pasoja të paqëllimshme. Gjendjet e reja sociale, nga njëra anë përmirësonin sjelljet e vjetra dhe të papranuara, kurse nga ana tjetër zëvendësonin mospajtimet mes grupeve të ndryshme shoqërore me çështje të reja dhe të panjohura. Duket se kjo është njëra ndër arsyet më të forta për vazhdimësinë e dukurisë së pabarazisë gjinore, e cila vazhdon të mbetet ndër çështjet më aktuale shoqërore në të gjitha vendet e botës.

Fjalë kyçe: barazia gjinore, ndryshimet shoqërore, diskriminimi

I. Dallimet dhe ngjashmëritë mes gjinive

Lidhshmëria mes gjinive kushtëzohet nga pabarazia e përhershme që ka ekzistuar mes meshkujve dhe femrave. Studiuesit e shkencave shoqërore gjithmonë kanë qenë në kërkim të definimit të shkaqeve më relevante të pabarazisë gjinore. Varësisht prej kohës dhe hapësirës, rezultatet nga hulumtimet e shumta në këtë drejtim japin të dhëna të ndryshme. E përbashkëta e rezultateve që posedojmë tregon për eksploitime të ndryshme të grave, varësisht prej faktorit kohë dhe hapësirë.

Të gjitha shoqëritë kanë qenë të vetëdijshme për ndarjet e ndryshme mes njerëzve, si në baza ekonomike ashtu edhe në baza të përgjithshme kulturore, dhe gjithmonë janë proklamuar për arritjen e një shkalle më të lartë barazie.

Megjithëse burrat dhe gratë janë shumë të ngjashëm, përsëri dallimet mes tyre tërheqin kujdes të madh. Gjithmonë është parashtruar pyetja, vallë këto dallime janë si rezultat i mënyrës së edukimit të burrave dhe grave ose këto dallime janë të kushtëzuara nga natyra e tyre biologjike. Për të fituar një përgjigje sa më të saktë rreth kësaj dileme,

organizata Galup⁵ në vitin 1990 realizoi një hulumtim që kishte për qëllim të vërtetojë dallimet në interesat dhe aftësitë mes burrave dhe grave. Rezultatet e fituara nga anketa e realizuar tregojnë mendime të ndryshme rreth kësaj problematike. Gjysma e të anketuarve janë deklaruar se dallimet thelbësore mes burrave dhe grave janë rezultat i edukimit të tyre, përkatësisht i rritjes së tyre, kurse gjysma tjetër e të anketuarve janë deklaruar se shkak i ndryshimeve është natyra biologjike.⁶ Padyshim se dallimet biologjike mes burrave dhe grave janë evidente, por ngjashmëritë mes tyre, para së gjithash si pjesë e bashkësisë shoqërore janë më të mëdha. Ato janë si dy duart, pa dallim e majta apo e djathta, të dyja secilit individ i duhen, dhe ashtu siç nuk ka individ i cili kujdeset vetëm për njërin dorë, në të njëjtën mënyrë nuk duhet të ketë as shoqëri që do të kujdeset vetëm për njërin gjini.

Kur flasim për gjininë, kemi parasysh aspektin social të burrit/gruas në organizimin dhe veprimtarinë e përgjithshme shoqërore. Zhvillimi socio-ekonomik dhe kulturor nuk ka arritur të tejkalojë pozitën historike të gruas dhe rolin e saj në të gjitha sferat e jetës. Pozita jo e barabartë e gruas me burrin argumentohet dhe mbështetet në forcën jo të barabartë, si rezultat i së cilës pasojnë edhe ndarjet jo të barabarta të punës dhe vlerësimit të saj, dallimet në pozitat shoqërore, në përgjegjësi dhe mundësi të barabartë në proceset e vendimmarrjes etj. Megjithëse ka ndryshime për sa i përket rolit të grave dhe burrave, në kultura të ndryshme nuk njihet ndonjë shembull i ndonjë shoqërie, ku gratë të jenë më të fuqishme se burrat. Gratë janë kudo të interesuara për rritjen e fëmijëve dhe mbajtjen e shtëpisë. Nga ana tjetër, kritikja franceze Simone de Beauvoir, nuk pajtohet se dallimet gjinore burojnë nga forca fizike e burrave. Këtë pohim e argumenton me mendimin se vet fëmijët – familja, pengojnë gratë për të marrë pjesë në veprimtaritë më publike, ku burrat shumë lirshëm mund të angazhohen. Në shoqëritë industriale, ndarja e punëve mes burrave dhe grave është shumë më e paqartë se në shoqëritë paraindustriale. Në mesjetë, veprimtaritë prodhuese dhe ato shtëpiake nuk ishin të ndara. Thuajse të gjitha familjet merreshin me bujqësi ose zejтари, punët bëheshin në shtëpi ose afër saj. E përbashkëta

⁵ Gallup, George (1901-1984)-Hulumtues amerikan i shkencave sociale dhe pionier i teknikave analitike në studimin e qëndrimeve politike dhe të opinionit publik. Gallupi është emër që lidhet me një model të hulumtimit, i cili sot quhet “Sondazhi i Gallupit”, që realizohet nga kompania shumëkombëshe amerikane e cila e mban emrin e tij.

⁶ David, M.G., (2003), *Socialpsikologjia*, Uegen, Tiranë, f.174 (libër i përkthyer)

është se në të gjitha shoqëritë burrat i tejkalojnë gratë në aspektin e pushtetit dhe influencës. Me zhvillimin e industrisë filloi edhe migrimi prej fshati në qytet. Burrat filluan të punësohen nëpër fabrika, tani duke bërë kontrata individuale me punëdhënësit. Kjo linte anësh gratë dhe fëmijët e tyre, përveçse në raste të rralla kur fëmijët dhe gratë e punëtorëve angazhoheshin për punë në fabrika ose si shërbëtor shtëpiak në familjet e të pasurve.

I.1. Stereotipizimi gjinor

Duke u nisur nga faktet historike për zhvillimet dhe ndodhitë nëpër botë, vërehet qartë se të gjithë proceset, lëvizjet, luftërat, zbulimet etj., u përshkruhen vetëm burrave. Duke krahasuar periudhën e kaluar historike me të sotshmen, nga aspekti i aftësive reale ndërmjet grave dhe burrave, mund të konstatojmë se burrat kanë mbizotëruar. Sot të gjithë pajtohen se ndërmjet grave dhe burrave nuk ka dallime në inteligjencë, ashtu siç nuk ka pasur edhe në të kaluarën, por krijimtaria intelektuale e grave gjithmonë ka qenë e kufizuar. Sukseset e tyre të arritura në të gjitha fushat e krijimtarisë artistike u janë përshkruar burrave. J. Koteska thekson se “Në Maqedoni, qëndisja është aftësi tradicionale e grave, me të cilën gratë në mënyrë aktive dhe me shekuj kanë bërë dekorime të ndryshme”.⁷ Në katalogun e Shoqatës së artistëve figurativ të Maqedonisë prej vitit 1990 figurojnë pesë emra burrash dhe asnjë emër gruaje. Kjo na shpie në përfundimin se: “*Kur burri merret me qëndisje, ajo është formë arti, kurse kur me qëndisje merret gruaja, ai aktivitet pranohet vetëm si nivel aftësie ose si aktivitet shtëpiak.*”⁸ Trajtimet e këtilla të krijimtarisë femërore janë të njohura anembanë botës, edhe atë në të gjitha sferat. Kështu sot zbulohen dhe vërtetohen shumë aktivitete dhe krijimtari artistike të cilat në të kaluarën kanë qenë të zbuluara ose krijuara nga gratë, kurse historia ua përshkruan burrave.

Shumë aspekte nga jeta bashkëkohore në mënyrë direkte janë të lidhura me zhvillimin kulturor të rrethit shoqëror. Stereotipat e ndërtuar për gratë ende nuk janë çrrënjësuar nga shumë vende, bile edhe në vendet më të zhvilluara diskriminimi i fshehur vazhdon të jetë prezent. Edhe përkrah normave dhe rregulloreve të fuqishme ligjore, në shumë vende

⁷ Котеска Ј., (2002), *Македонско женско писмо: Теорија, историја и опис*, Македонска книга, Скопје, f.22

⁸ По ату, f.22-23

të zhvilluara, për punën e njëjtë të ardhurat për burrat dhe gratë nuk janë të njëjta. Për këto arsye procesi i afrimit, gjegjësisht përparimit të drejtave dhe mundësive të grave vazhdojnë të jenë aktuale. Lëvizjet feministe intensitetin më të madh e arrijnë në vitet 60-ta të shekullit të kaluar me çka një pjesë e kërkesave të tyre kanë fituar vend në rregullativat ligjore të shumë vendeve, porse shumica e tyre edhe sot e kësaj dite kanë vetëm karakter deklarativ. Mundësitë dhe të drejtat e barabarta të të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë, askush nuk i pengon, por situata reale për arritjen e barazisë gjinore kushtëzohet nga më shumë faktorë, para së gjithash nga tradita, mënyra e kuptimit dhe pranimi të pozitës vetjake në shoqëri, respektimit të ndryshimeve nga natyra biologjike etj.

I.2. Familja dhe karriera

Çështja e përparimit në karrierë është kushtëzuar nga rregullimi i detyrave dhe përgjegjësiive prindërore në familje. Sot, shumica e njerëzve pajtohen me mendimin se gratë duhet të kenë të njëjtat mundësi për karrierë, ashtu si burrat, nga ana tjetër shumë njerëz janë të mendimit se detyra e prindit nuk mund të jetë e barabartë për burrin dhe për gruan. Shumë gra shihen si të prira për të ndërprerë karrierën për hir të kujdesit ndaj fëmijëve, pavarësisht se sa e lartë mund të ishte pozita që mund të kishin arritur. Një menaxher komentonte:

*“Meshkujt priren të sundojnë në nivele të larta thjeshtë sepse gratë shkëputen për të lindur fëmijë dhe gjëra të tjera lidhur me këto... Unë nuk mendoj që kjo është një ngritje selektive në përgjegjësi, por një fakt jetësor që gratë tentojnë të largohen, të marrohen dhe të kenë familjet e tyre e për këtë arsye ato kanë një karrierë të copëzuar. Ato kthehen përsëri, por kanë një boshllëk në përvojë ose në kualifikim dhe kur ju e ndeshni këtë dhe seleksiononi kandidatët nuk është seksi i kandidatit, por ajo çka mund të japin ato për punën e tyre që ndikon në këtë seleksionim. Ja, merrni një kandidate grua që ka qenë tre vjet larg punës për arsye familjare dhe një burrë që ka qenë në punë. Është shumë e qartë se burri ka më shumë mundësi të punësohet, po të marrim rastin kur të gjitha të dhënat e tjera kandidatët i kanë të barabarta”.*⁹

Padyshim se rregullativat ligjore në vendet e zhvilluara punojnë në drejtim të zgjidhjes së kësaj problematike. Në shumë vende praktikohet *pushimi i lindjes* edhe për burrat, që nënkupton se kujdesi për

⁹ Homans, H., (1987), ‘Man-made myth: The reality of being a woman scientist in the NHS’, London, f.95.

familjen dhe fëmijët të jetë sa më i barabartë për burrin dhe gruan. Deri tani ishte fakt i jetës se gratë janë shumë të pafavorizuara në krahasim me burrat në mundësitë e tyre për karrierë. Tentimet e fundit shoqërore për të arritur mundësi sa më të përafërta mes gjinive, me siguri se do të nxisin dukuri tjera negative dhe të padëshirueshme shoqërore, sidomos përbrenda familjes.

I.3. Diskriminimi gjinor

Gjinia si konstrukt social fillon të ndërtohet që në familje. Me përcaktimin e identitetit seksual, bëhet edhe përcaktimi i identitetit gjinor. Medicina identifikon seksin e foshnjës ende pa u lindur, kurse prindërit që në atë moment fillojnë me përgatitjet e ndërtimit gjinor. Ata ngjyrosin dhomën me ngjyra varësisht nga gjinia e foshnjës që presin, blejnë kukulla, tesha me ngjyrë të kuqe ose vjollcë për femra, etj. Intensiteti dhe dinamika e jetës ndikojnë në planifikimin e familjes, me çka numri i familjeve me pak fëmijë është në rritje, kurse familjet me tre e më shumë fëmijë janë shumë të rralla. Dallimet mes foshnjave femra dhe atyre meshkuj thuajse nuk janë aspak të dukshme, kurse familja që në ditët e para fillon me forma të ndryshme të ndikimit në formimin e identitetit gjinor. Duke filluar nga përkëdheljet, si: e ëmbël, e butë, princesshë etj., për vajzat, pastaj në shumë kultura ekzistojnë edhe dallime në këngët që u këndohen apo përrallave që u tregohen. Në këtë mënyrë që në vitet e para të jetës familja i bën me dije fëmijës vendin dhe rolin në shoqëri. Në një hulumtim realizuar nga Will, Self dhe Datan (1976), për mënyrën se si zhvillohen ndryshimet midis përkatësive gjinore, rezultoi se ndërveprimi nënë-fëmijë tregon ndryshime në trajtim të djemve dhe vajzave, madje edhe kur prindërit besojnë se reagimet e tyre janë të njëjta për të dy. *“Të rriturit e pyetur për të dhënë një vlerësim për personalitetin e foshnjës japin përgjigje të ndryshme sipas rastit nëse ata e dinë ose jo se fëmija është vajzë apo djalë. Në një eksperiment disa nëna të reja u vëzhguan gjatë ndërveprimit me një fëmijë gjashtë muajsh të quajtur Beth. Ato përpiqeshin ti buzëqeshnin asaj shpesh dhe i ofronin kukulla për të luajtur. Ajo ishte e “ëmbël” dhe “qante me zë të butë”. Reagimi i një grupi të dytë nënash ndaj një fëmije të së njëjtës moshe të quajtur Adam ishte shumë i ndryshëm. Fëmijës i ofrohej një tren ose “lodra të tjera për meshkuj” për të luajtur. Beth dhe Adam në të vërtetë ishin i njëjti fëmijë i veshur me rroba të*

ndryshme".¹⁰Trajtimi i foshnjave dhe i fëmijëve vazhdon të ndikohet në të njëjtën mënyrë edhe nga rrethi social më i gjerë.

Qëllimi parësor i çdo shoqërie është arritja e mirëqenies shoqërore në shkallë sa më të lartë. Gjithmonë duke përmirësuar vetitë dhe sjelljet negative ndaj pjesëtarëve të grupeve të ndryshme. Shikuar nga aspekti i ndërveprimit shoqëror, sociologët theksojnë se jo çdoherë synimet njerëzore rezultojnë me pasojat e dëshirueshme. Shumë nga sjelljet njerëzore, sidomos ato me karakter diskriminues llogariten si veprime të padukshme dhe shpesh herë edhe të paqëllimshme. Dekadave të fundit aktualizohen sjelljet më diskriminuese me të cilat ballafaqohen në vazhdimësi shoqëritë, si racizmi dhe seksizmi. Seksizmi si formë e hapur e diskriminimit, bazohet në përkatësinë gjinore. "*Ai paraqitet në formë të hapur të aktivitetit shoqëror, si lloj ndalimi drejtuar përfaqësuesve të gjinisë tjetër. Shumë gra, por edhe burra nuk janë të vetëdijshëm se mbulohen me seksizëm*".¹¹Edhe pse nuk mungojnë rezultatet e lëvizjeve për të drejtat e njeriut, përfshi këtu edhe ato feministe, përsëri barazia gjinore paraqet një problematikë shumë komplekse. Në tentim të arritjes së qëllimeve për barazi mes burrave dhe grave, disa herë ndodh edhe fenomeni i njohur në socialpsikologji, si **Diskriminimi i kundërt** (*jep me një dorë, merr me tjetrën*). Në disa raste, njerëzit që kanë një nivel të caktuar paragjykimi ndaj anëtarëve të një grupi të caktuar shoqëror mund të sillen në mënyrë të favorshme ndaj tyre, madje, më të favorshme sesa po të mos ishin anëtarë të këtij grupi. Ndodh që një i bardhë të tregojë më tepër respekt ndaj një zezaku, sesa ndaj të bardhëve. Raste të njejta diskriminimi janë edhe ato të aspektit gjinor, ku tregohet kujdes i tepërt ndaj pjesëtarit pakicë nga ana e grupit, pamarrë parasysh gjininë.¹²

Përfundim

Shumë nga çështjet sociale, përfshirë këtu edhe diskriminimin, vazhdojnë të përmirësohen, por gjithmonë duke u zëvendësuar me forma të reja negative. Nëse sjellja normale e para shumë viteve sot konsiderohet si shumë negative, tani është tejkaluuar dhe njëkohësisht

¹⁰ Will, J., P. Self dhe N. Datan.,(1976), "Maternal behaviour and perceived sex of infant", *American journal of Orthopsychiatry*, f. 46.

¹¹ Barada, V., Jelavić, Z., (2004), *Uostalom, diskriminaciju treba dokinuti!* Centarzaženskestudije, Zagreb, f.36

¹² Dragoti, E., (1999), *Psikologjia sociale*, Libri Universitar, Tiranë, f.232

zëvendësuar me formë të re e cila pas disa viteve do të jetë e papranueshme nga gjeneratat e ardhshme. Veprimet njerëzore mbeten të paparashikueshme për implikimet anësore. Vlen të theksohet se në vitin 1800 numri i fëmijëve që jetonin me një prind ishte ndoshta i barabartë me numrin e sotshëm të fëmijëve që jetojnë me një prind. Në atë kohë shumë gra vdisnin gjatë lindjes ose shumë burra në luftë, kurse sot arsyeja kryesore është ndarja e prindërve – divorci.

Conclusion

Many of the social issues, including here discrimination too, continue to improve, but always substituting with new negative forms. If the normal behavior of many years ago is now considered as very negative, it is now exceeded and concurrently substituted with new form which after a few years will be unacceptable for future generations. Human actions remain unpredictable about side implications. It is worth emphasizing that in 1800 the number of children living with one parent was probably equal to the number of today's children living with one parent. At that time many women died out during childbirth or many men in the war, but today the main reason is the separation of parents - divorce.

Literatura e shfrytëzuar

- Barada, V., Jelavić, Z., *Uostalom, diskriminaciju treba dokuñiti!* Centar za ženske studije, Zagreb, 2004
- Barbara, J. B., (ed), *Gender and Education: An Encyclopedia*, Volumes I & II, Praeger, Westport, Connecticut London, 2007
- Giddens, A., *Sociologjia*, Cabej, Tiranë, 2002 (libër i përkthyer)
- David, M.G., *Socijalpsikologjia*, Uegen, Tiranë, 2003 (libër i përkthyer),
- Demir, Z., *Feminizmi modern dhe postmodern*, Logos-A Shkup/Prishtinë/Tiranë, 2006 (libër i përkthyer)
- Dragoti, E., *Psikologjia sociale*, Libri Universitar, Tiranë, 1999
- Homans, H., 'Man-made myth: the reality of being a woman scientist in the NHS', London, 1987
- Klimenko, T., *Žena kao kulturni fenomen*, Centar za ženske studije, Beograd, 2003
- Колозова, К. (red), *Истражувања од областа на родовите студии*, ТОМ 2/3, përgaditur në vitin 2001/2002, Евро Балкан Прес, Скопје

- Котеска Ј., *Македонско женско писмо: Теорија, историја и опис*, Македонска книга, Скопје, 2002
- Will, J., P. Self dhe N. Datan., “Maternal behaviour and perceides sex of infant”, *American journal of Orthopsychiatry*, 1976